



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:050227

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06652620

PAKR.nr.647/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - Kryetar i kolegjit, Vatun Durguti dhe Violeta Husaj Rugova - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit M.R për veprat penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe të pandehurit I.R, për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.R av. A.H, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.391/22 të datës 28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 26.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.R. av. A.H, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.391/22 i datës 28.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.391/22 të datës 28.04.2023, të akuzuarit M.R. për veprat penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 para.4 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së si dhe të akuzuarin I.R., për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar si në vijim:

Të akuzuarit M.R, për veprën penale, Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, ndërsa, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 4,000 Euro, të cilat dënime, do të ekzekutohen 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar.

Të akuzuarit I.R., për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim, do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar.

Konform dispozitave të nenit 44 par.1 dhe 2 të KPRK, me pëlqimin e të dënuarit I.R., dënimin me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë, në shumën prej 5000 euro, të cilin dënim i dënuari do ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar.

Nëse të akuzuarit M.R dhe I.R., nuk munden apo nuk dëshirojnë ta paguajnë dënimin me gjobë, të njëjtëve secilit veç e veç, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që, për çdo 20 (njëzet) euro të dënimit me gjobë, do të qëndrojnë nga një ditë në burg.

Konform neni 79 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar të pandehurit M.R., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.03.2022 deri 07.04.2023.

Konform nenit 79 par.1 të KPRK-së, ku në dënimin e shqiptuar të pandehurit I.R., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 11.06.2022 deri 01.08.2022, ashtu që për çdo ditë të qëndrimit në arrest shtëpiak, do t'i zbriten nga 20 (njëzet) euro të dëmit me gjobë.

Të dëmtuarit: E.B, nga Prishtina, Lagja Arbëria (Dragodan) rruga : “Eduard Lir”, H-104; L.B, nga Prishtina, lagja Bregu i Diellit, rruga: Rifat Buryevic”, H-6, nr.8; Sh.B., nga Prishtina, rruga: “Xheladin Hana”, objekti IV, nr.35 dhe G.M, nga Prishtina, rruga: “Ndue Përlleshi”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Janë detyruar të pandehurit, që në mënyrë solidarë t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri M.R., shumën prej 200,00 (dyqind) € (euro), ndërsa, i pandehuri I.R., shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe në emër të kompensimit të Viktimave të Krimin, secili veç e veç, të paguaj shumën prej nga pesëdhjetë (50) € (euro), të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita kur aktgjykimi i ankimuar të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Konform nenit 113 të KPP, të pandehurit M.R., i kthehet në posedim vetura e sekuestruar e tipit BMW, me targa regjistrimi 02-113- FH, ngjyrë e zezë.

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe nenit 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të sendeve: (të sekuestruara sipas “Lista e armëve të konfiskuara, me Nr.të dosjes 2022-AC-0379, të datës 16.03.2022) në vijim:

- Revole e tipit, “Crevena Zastava M57” e kalibrit 7.62x25 mm, me numër serik
- gjashtë fishekë të kalibrit 7.62x25 mm.

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar, e njëjta duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër penal.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit M.R. av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes së ligjit penal si dhe për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje apo që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje dhe rigjykim.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.585/2023 të datës 20.11.2023 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.R. av.A.H., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoj seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka prezantuar i akuzuari M.R., mbrojtësi i tij av. A.H. ndërsa nuk prezantojnë të dëmtuarit E.B. dhe L.H. dhe Prokurori i Apelit edhe pse të njëjtit kanë qenë të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit M.R. av. A.H. dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se: **Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore

Mbrojtësi i të akuzuarit M.R. av. A.H., në ankesë thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me dispozitën e nenit 384 par. 2 nën par 2.7 lidhur me dispozitën e nenit 369 par.6 edhe 7 të KPPRK-së. Aktgjykimi i atakuar, nuk është përpiluar në përputhje me dispozitën e nenit 369 par. 6 edhe 7 të KPPRK-së nga se Gjykata në arsyetimin e saj, nuk ka paraqit arsyet, për secilën pikë të aktgjykimit si edhe nuk ka paraqitur kuart edhe në mënyrë të plotë se cilat fakte edhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk është dhënë arsye e mjaftueshme ligjore për vërtetimin me saktësi të plotë të fakteve edhe rrethanave vendimtare po ashtu nuk ka vlerësua me saktësi, provat kundërthënëse e aq më pak të ketë dhënë arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike ku arsyetimi i ofruar është në kundërshtim me

vetveten. Kjo për faktin se me ndryshimin e përshkrimit faktik në aktakuzë përkatësisht heqjen e fjalëve të caktuara edhe shkruarjen e fjalëve të reja në përshkrim faktik të dispozitivit të aktgjykimit, mbrojtja konsideron se nuk është aspak e kuart se si apo nga cila provë fillimisht i ka vërtetuar veprimet e përshkruara gjykata kurse njëkohësisht veprimet e përshkruara në asnjë mënyrë nuk e konsumojnë veprën penale për të cilën është shpall fajtor. Nuk qëndron e as nuk është arsyetuar mjaftueshëm gjetja e gjykatës në faqe 17 pasuesi i 2 se kinse është vërtetuar elementi subjektiv i veprës penale nga se në momentin kritik i akuzuari nuk kishte fol me dy personat që i kishin dal në rrugë në afërsi të shtëpisë së tij edhe kjo për faktin se i njëjti i ka pasur xhamat mbyllur edhe nga CD e administruar me propozim të mbrojtjes shihet mirë se i akuzuari M.R. hyn në atë rrugë me një shpejtësi në tenaltëze ku papritmas i vëren dy persona të veshur në të zeza me armë në dorë ku nuk ka prova që është ndalur apo të ketë biseduar me ta si thuhet në faqe 17 pasusi i 2 në aktgjykim por e tëra ka ngja shumë shpejt ku me të vërejtur personat e ka rritur shpejtësinë ku njeri nga ta është largu edhe ka shtënë me armë menjëherë e pastaj edhe tjetri me të cilat të shtëna e kishin goditur veturën e të akuzuarit ku në atë moment të akuzuarit M.R. i ka shkrep arma në drejtim të panjohur e jo në drejtim të tyre. Nisur nga kjo gjendje nuk është vërtetuar se ai të ketë folur me personat e as që të iu janë prezantuar ata në mënyrë që të thuhet në dispozitiv të aktgjykimit si edhe ne arsyetim ne faqe 17 pasusi i 2 se kinse nuk i ka përfill urdhrat apo të ketë ditur se kush janë e aq më pak të konsiderohet se i ka kanos policët për të cilët nuk e ka ditur kush janë aq më pak të veshur në të zeza edhe të armatosur. Në favor të asaj se nuk e ka ditur kush janë ata dy persona të cilët i kanë dal në pritë në afërsi të shtëpisë së tij është edhe vet arsyetimi i pakuptimtë i gjykatës në faqe 18 pasusi i 3 ku shkruan “nuk është kontestuese se i pandehuri natën kritike në vend ngjarje kishte hasur në dy persona në rroba civile e të cilët rezultuan të jenë polic e që nisur nga ky lloj konstatimi rrjedhimisht kuptohet se i akuzuari nuk ka dashur kontakt me personat në fjalë por ka has në ta në afërsi të shtëpisë së tij si edhe vet gjykata konstaton se personat ishin me rroba civile të cilët më pas kanë rezultuar se janë polic gjë që ngërthen në vete se në momentin kritik i akuzuari M.R. nuk e ka ditur se janë polic andaj si mund të thuhet se është vërtetuar elementi subjektiv i veprës penale në fjalë? Në favor të asaj se nuk ka folur asgjë me personat me rroba civile edhe se realisht ata ishin të armatosur me armë në duar kur është afruar vetura e të akuzuarit M.R. është fakti logjik se personi i quajtur E.B. me tu shtrirë ka shtënë me armë menjëherë edhe e ka godit veturën e të akuzuarit M.R. e që nëse kemi për bazë shpejtësinë me të cilën ka lëviz në atë moment i akuzuari M.R. ku ata i ka përshkruar për më së shumti 3 sekonda, nuk është e besueshme që E.B. në një dorë të ketë pasur distinktivin e policisë me bateri e në dorën tjetër radiolidhjen edhe aq shpejt të ketë nxjerrë revolen ta ketë repetit edhe gjuajt në drejtim të

akuzuarit M.R. ku e ka godit veturën e tij e të gjitha këto për 3 sekonda. E vërteta është realisht se E.B. i veshur në rroba civile kishte armën në dorë në momentin kur vjen vetura e të akuzuarit M.R. edhe menjëherë shtëne mbrapa saj gjë që ngërthen në vete se i akuzuari M.R. nuk ka mund të flas me persona të armatosur në rroba të zeza natën edhe nuk e ka ditur se kush janë gjë që ngërthen në vete se nuk ekziston elementi subjektiv i veprës penale në fjalë. Në favor të asaj se ai nuk e ka ditur se janë polic është edhe deklarimi i personit L.H. cili ka thënë se pas 300 metra vetura ishte ndal ku M.R. fliste me policët e uniformuar ku ka ndëgju fjalët “më gjuajti dikush” pra në këto rrethana kuptohet se i akuzuari M.R. është ndal pas ngjarjes edhe nuk ka ikë por ka ndal oficerët policor të uniformuar ku iu ka thënë se “më gjuajti dikush” ku me fjalët “më gjuajti dikush” kuptohet se nuk e ka ditur kush janë ata të cilët e kanë gjuajt në një rënë anë ndërsa në anën tjetër kuptohet se ai me të kërkuar ndihmë nga policët e uniformuar ngërthen në vete se ai me policët nuk ka pas problem e as arsye e motiv për të shtënë në ta apo mosmarrëveshje. Vet dëshmitarët L.H. edhe E.B. kanë deklaruar se nuk e din M.R. a i ka njohur a jo natën kritike gjë që është në favor të asaj se ai nuk e ka ditur që janë polic ata. Nuk është kontestuese se dy “të dëmtuarit” natën kritike ishin të veshur me rroba civile në të zeza edhe ishte errësirë në vend të ngjarjes që është vetëm 20C metra larg shtëpisë se të akuzuarit M.R. e që i njëjti ishte futur në atë rrugë për të shkuar në shtëpi. Nuk është kontestues fakti se i akuzuari M.R. ishte i kanosur seriozisht për jetë nga personat të cilët i ka përmendur në deklaratë edhe që zhvillohet procedurë penale për veprat penale ku është i dëmtuar si edhe është shiku CD ku vetëm pak ditë para ngjarjes shihen një natë persona të maskuar e të armatosur në afërsi të shtëpisë së tij përkatësisht vendit ku ishte ai andaj ky fakt është skjaru mjaft mirë nga mbrojtja edhe me propozim të dëshmitarëve të cilët do të dëshmonin për këto rrethana por që jemi refuzu nga trupi gjykes pa asnjë arsyetim. I akuzuari M.R. nuk i ka njohur “të dëmtuarit”, nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme që i ka njohur apo që e ka ditur kush janë apo çfarë janë ata njerëz. I akuzuari meqenëse kishte armë me vete është e logjikshme të mos shkoj në drejtim të tyre por në drejtim të kundërt gjë që njëkohësisht e bën të palogjikshëm pretendimin në aktgjykim. Tutje mbrojtja shton se përshkrimi faktik i ri në aktgjykim nga gjykata nuk e konsumon figurën e veprës penale për të cilën është shpall fajtor i akuzuari M.R. Kjo për faktin se mospërfillja e urdhrave apo largimi nga aty nuk e konsumojnë veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar kjo nga se fillimisht nuk është vërtetuar se janë dhënë urdhra kurse në anën tjetër personave të veshur me rroba civile të zeza me armë në dorë të cilët shtijnë me armë në drejtim të një qytetari, nuk i mbetet tjetër veç se të rrit shpejtësinë edhe të largohet kurse nuk mund të anashkalohe rrethana se personat në fjalë në asnjë mënyrë nuk janë rrezikuar apo sulmuar. Mbrojtja thekson se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht ngase nga administrimi i provave në shqyrtim kryesor nuk rezulton se

është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin I të aktgjykimit. Kjo për faktin se provat në fjalë flasin të kundërtën në masë të madhe në një rën anë kurse në anën tjetër me ato prova nuk dëshmohet përtej dyshimit të bazuar elementi subjektiv i veprës penale por në masë të madhe faktet edhe rrethanat vendimtare janë keqinterpretuar. Sipas mbrojtjes me vet faktin se Aktgjykimi është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe me vërtetim të gabuar edhe jo të plotë të gjendjes faktike për pasojë ka edhe shkelje të ligjit penal. Përkitazi me vendimin mbi dënim mbrojtja konsideron se dënimi i shqiptuar është i padrejtë edhe tepër i lartë kur për këtë veprë penale për të cilën e ka shpall fajtor përcaktohet dënim nga 1 vit gjer në 8 vite në rrethana pa asnjë rrezik apo dëmtim trupor edhe pa asnjë pasoje reale fizike apo psikike për “të dëmtuarit” është shqiptu dënim prej 3 vite burgim. Njëkohësisht për veprë të njëjtë të akuzuarit tjetër iu është shqiptu dënim shumë më i butë në lartësi prej 6 muaj burgim me mundësi zëvendësimi me gjobë në shumë prej 5000 euro edhe pse nga veprimi i këtij të akuzuari janë pësuar dëmtime trupore ndërsa nga veprimi i të akuzuarit M.R nuk janë pësuar dëmtime trupore gjë që është e padrejtë, ngase drejtësia nuk mund të jetë selektive edhe të dallon aq shumë. Mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e lartë cekura ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të tij.

Gjykata e Apelit, gjen se janë të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 e lidhur me nenin 369 par.7 të KPRK-së, ngase në dispozitivin e aktgjykimit janë përshkruar në tërësi veprimet inkriminuese të cilat formojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike, për të cilat arsye edhe kjo gjykatë i aprovon si të drejta dhe ligjore. Prandaj, përkitazi me pretendimin ankimor se me ndryshimin e përshkrimit faktik në aktakuzë përkatësisht heqjen e fjalëve të caktuara edhe shkruarjen e fjalëve të reja në përshkrim

faktik të dispozitivit të aktgjykimit, mbrojtja konsideron se nuk është aspak e kuart se si apo nga cila provë fillimisht i ka vërtetuar veprimet e përshkruara gjykata kurse njëkohësisht veprimet e përshkruara në asnjë mënyrë nuk e konsumojnë veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se ky pretendim është i pabazuar ngase gjykata e shkallës së parë në këtë rast nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor ka vërtetuar veprimet inkriminuese si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke mos u detyruar me kualifikimin ligjor të veprës penale nga prokuroria e rrjedhimisht të mos ketë cenuar kështu identitetin objektiv të akuzës në këtë çështje penale, konform nenit 359 par.2 të KPP-së.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ku në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprave penale nga i akuzuari dhe nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, pra gjykata e ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë, edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari M.R. është kryerës i veprave penale për të cilat është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari M.R. në mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, për faktin se me datë 15.03.2022 rreth orës 21:19, ne rrugën “Mentor Rekoceri” në Prishtinë, përderisa i pandehuri M.R. ishte duke lëvizur me veturën e tipit BMW ngjyrë e zezë ma targa ...-...-..., në drejtimin të shkollës “Zenel Hajdini”, me dashje ka sulmuar policinë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në atë mënyrë që, derisa në ato momente, zyrtarët policor E.B. dhe L.H., kanë qenë duke patrulluar në këmbë të angazhuar në planin operativ (rroba civile) për parandalim të vjedhjeve dhe veprave tjera penale, i pandehuri M.R., policëve ju ka ofruar me veturë, i ka ofendu me fjalë duke ju thënë “edhe të shpija më keni ardhë, motrat jau

.....”, ashtu që, në atë moment zyrtari policor E.B. i ka dhënë shenjë që të ndalet, ka ngrit dorën duke i treguar disniktivin e policisë, e ka urdhëruar me zë të lartë, “Policia ndal”, mirëpo i pandehuri M.R. nuk i ka përfillur urdhrat e policisë, përkundrazi vullshëm ka rrit shpejtësinë e veturës, ka tentuar ta godas me veturë policinë duke shkuar në drejtim të tij, ashtu që zyrtari policor E.B., duke pa rrezikun, ka kërcye nga ana e tij e djathë, duke u larguar prej rruge, ndërsa i pandehuri M.R. ka vazhduar me veturë, duke e kanosur me përdorim të armës, dhe për një moment me një pistoletë të tipit M -57, ngjyre e zeze me nr. serik 23834, nga vetura e tij, nga një distance e shkurte, ka shtënë një herë përpara, përkatësisht në xhamin e përparmë të veturës së tij; si dhe me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i pandehuri M.R. ka mbajtur në posedim një armë zjarri, pistoletë e tipit M -57, ngjyrë e zezë me nr.serik, me karikator dhe pesë fishekë, të cilën armë i pandehuri e ka mbajtur në pronësi dhe kontroll në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L -022, me ç’rast e njëjta armë i është sekuestruar si dëshmi nga ana e policisë.

Deri tek kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe materiale si: dëgjimi i të dëmtuarve-dëshmitarëve L.H. dhe E.B., Raporti i Ekspertimit nga AFK, i datës 24.04.2022, Raporti njoftues me nr. ref. 2022-AC-0479, i dt. 04.04.2022, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, lista e dëshmimeve me zinxhir të ruajtjes, Raporti i ekzaminimit të veturës, CD-ja me incizime, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i dt. 15.03.2022, Informacionet e personit të PK – për të pandehurin M.R., foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, marrjen në pyetje e të akuzuarit M.R. si dhe shkresa të tjera që i janë bashkangjitur lëndës.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë në këtë çështje penale, e të përshkuar si më lartë andaj, kolegji penal përkitazi me pretendimin ankimor në thelb, *se i akuzuari nuk ka mund të dijë se të dëmtuarit, ditën kritike, ishin zyrtarë policor*, për kolegjin penal të kësaj gjykate është i pabazuar ngase nga deklarata dhe dëgjimi në shqyrtim gjyqësor të dëmtuarve-zyrtarëve policor E.B. dhe L.H., ku dëshmitari-zyrtari policor E.B. kishte dëshmuar se i ka dhënë shenjë që të ndalet, ka ngritur dorën duke i treguar disniktivin e policisë, e ka urdhëruar me zë të lartë “Policia ndal”, mirëpo i pandehuri M.R. nuk i ka përfillur urdhrat e policisë, përkundrazi vullshëm ka rrit shpejtësinë e veturës, ka tentuar ta godas me veturë policët duke shkuar në drejtim të tyre, ku E.B.-zyrtarë policor, duke pa rrezikun, ka kërcyer në anën e tij të djathtë, duke

u larguar prej rrugës, ndërsa i pandehuri M.R. ka vazhduar me veturë, duke e kanosur me përdorim të armës, një pistoletë të tipit M-57, ngjyrë të zezë, nr.serik, nga vetuar e tij, nga distanca e shkurt ka shtënë një herë përpara-xhamin e përparmë të veturës së tij. Edhe i dëmtuari-dëshmitari L.H., në dëshminë e tij, ka dëshmuar se në ditën kritike, kolegu i tij, këtu dëshmitar E.B. kishte pasur në dorë baterinë dhe ID kartën e policisë, e cila ka drejtuar barin në drejtim të ID kartës së policës si dhe duke i dhënë komand verbale, mirëpo i pandehuri përsëri kishte vazhduar me shpejtësi në drejtim të tij duke tentuar ta godas duke i rrezikuar për jetë, andaj nga kjo gjendje faktike e vërtetuar në mënyrë të plotë rrjedh se pretendimi ankimor është i pabazuar dhe që i akuzuari natën kritike ishte vu në dijeni nga të dëmtuarit, në mënyrën e përshkruar si më lartë, se të njëjtit ishin zyrtarë policor dhe që nuk i është bindur urdhrave të tyre por i njëjti ka vazhduar në drejtim të tyre me veprimet e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Andaj, meqenëse aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me gjendjen e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk ka shkelur as *ligjin penal* siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesën e tij. Kjo për faktin se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, se për këto vepra penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të akuzuarit përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që, konform dispozitës së neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit ashtu që në raport me të pandehurin M.R., nuk gjeti asnjë rrethanë lehtësuese, ndërsa, si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë mori faktin se i njëjti është recidivist i shumëfishtë i veprave penale, edhe atë përveç tjerash është i gjykuar dhe dënuar me aktgjykime të formës së

prerë, P.nr.5006/18, PKR.nr.71/21, sidomos faktin se i njëjti, është i skeduar penalisht për vepra penale kundër jetës dhe trupit si dhe shitblerje të substancave narkotike.

Andaj, Gjykata e shkallës së parë duke marr për bazë rrethanat e përmendura më lartë, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë të pandehurit. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka vlerësuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve, nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre; të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit M.R. av.A.H., *se dënimi i shqiptuar është i padrejtë edhe tepër i lartë kur për këtë veprë penale për të cilën e ka shpall fajtor përcaktohet dënim nga 1 vit gjer në 8 vite në rrethana pa asnjë rrezik apo dëmtim trupor edhe pa asnjë pasoje reale fizike apo psikike për “të dëmtuarit” është shqiptuar dënim prej 3 vite burgim, po ashtu për veprë të njëjtë të akuzuarit tjetër iu është shqiptu dënim shumë më i butë në lartësi prej 6 muaj burgim me mundësi zëvendësimi me gjobë në shumë prej 5000 euro edhe pse nga veprimi i këtij të akuzuari janë pësuar dëmtime trupore ndërsa nga veprimi i të akuzuarit M.R. nuk janë pësuar dëmtime trupore*, nuk qëndrojnë kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh të gjitha të lartcekurat mirëpo ka vlerësuar se në rastin konkret dënimi me burgim dhe me gjobë për veprat penale për të cilat ngarkohet i akuzuari është adekuat dhe i drejtë. Ky kolegji penal mbështet përfundimin e shkallës së parë duke vlerësuar se pretendimet ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit nuk janë të asaj natyre të cilat kishin për të justifikuar dhe ndikuar për një vendim dhe lartësi tjetër nga ai i shqiptuar si në aktgjykimin e ankimuar, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të këtij kolegji penal japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Gjykata e Apelit një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit e gjen si të drejtë dhe të ligjshëm dhe të njëjtin e pranon edhe kjo gjykatë pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë

të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.647/23, datë 26.11.2024

Bashkëpunëtore Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Gresë Latifi

Vaton Durguti

Skender Çoçaj

Violeta Husaj Rugova
